



**VENDIM**

**Nr. 159, Datë 28.12.2015**

**PËR  
LICENSIMIN E SHOQËRISË “LE TRADING ALBANIA”  
SH.P.K. NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37 pika 2 gërma “ç”; 39 pika 3 dhe 110 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “P”; 5 pika 1, gërma “P”; 13 dhe 14 të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 108, datë 09.09.2008, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Le Trading Albania” sh.p.k. si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

**Konstatohet se:**

Aplikimi i shoqërisë “Le Trading Albania” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të plotë/ të pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/9, gërmat “a”; “b” dhe “c”); është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i ERE-s,

## **Vendosi:**

1. Të licensojë shoqërinë “Le Trading Albania” sh.p.k., në aktivitetin e Furnizimit të Energjisë Elektrike për një afat 5 – vjeçar.
2. Drejtoria e Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-s**  
**Petrit AHMETI**